

Sonte kunder Maqedonise fillon rrugetimi i Shqiperise ne Rusi 2018

nga Administrator

E hënë, 05 Shtator 2016 16:17



Sonte ne oren 20:45 fillon rrugetimi i kombetares Shqiptare ne eliminatoret e kampionatit boteror Rusi 2018. Shqiperia ben pjese ne grupin G, sebashku me Spanjen, Italine, Izraelin, Maqedonine dhe Lihtenshtain.

Kuqezinjte do te fillojne keto eliminatore kunder ekipit te Maqedonise. Ndeshja luhet ne stadiumin e rikonstruktuar te Shkoders, Loro Boriçi, dhe sipas informacioneve te dhene nga Federata Shqiptare e Futbollit pritet qe te jene me shume se sa 15000 tifozet.

Tranjeri Gianni de Biasi pritet qe te filloje ndeshjen me modulin 4-5-1 ku mund te trasformohet ne 4-3-3.

Ne porte pritet te jete i zakonshmi Berisha, ne mbrojtje do te rreshtohen Agolli, Mavraj, Gjimeshiti dhe Hysaj. Ne mesfushet, ku alternativat nuk mungojne, pritet qe te aktivizohen Kukeli, Lenjani, Xhaka, Abrashi, Gashi, por nuk perjashtohet mundesia qe ne vend te Lenjanit te luaje Hyka. Sulmi pritet ti besohet Sadikut. Pas pak dilemat e formacionit do te shuhen dhe do te shohim se me cfare formacioni do te filloje ndeshjen Shqiperia.